

**TERMAT E REFERENCES**

## Permbajtja

1.	HYRJE .....	3
1.1.	Përfituesi /Autoriteti Kontraktues .....	3
1.2.	Historiku.....	4
1.3.	Situata Aktuale në DPTTV .....	4
2.	OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA .....	5
2.1.	Objektivi i Përgjithshëm.....	5
2.2.	Qëllimi.....	5
2.3.	Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori .....	6
3.	SUPOZIMET DHE RISQET .....	6
3.1.	Supozimet e Projektit .....	6
3.2.	Risqet.....	6
4.	QËLLIMI I PUNËS .....	7
4.1.	Të Përgjithshme.....	7
4.1.1.	Përshkrimi i detyrës .....	7
4.1.2.	Hapësira gjeografike që do të mbulohet .....	8
4.1.3.	Grupet e synuara .....	8
4.1.4.	Siguria e sistemit.....	8
4.1.5	Detyrat specifike .....	9
	FAZA I: Faza Fillestre .....	9
	FAZA II: Zhvillimi i sistemit ne amnientin test te OE .....	9
	Faza III – Zhvillimi i Software për backup.....	9
	FAZA IV: Faza e testimit të sistemit software dhe sistemit të backup.....	9
	FAZA V: Trajnim i stafit përdorues .....	9
	FAZA VI: Furnizimi, instalimi, konfigurimi dhe integrimi i pajisjeve hardware .....	10
	FAZA VII: Dorezimi i kodit burim, skicave, konfigurimeve dhe manualeve te instalimit....	10
	FAZA VIII: Marrja ne dorezim .....	10
5.	LOGJISTIKA DHE KOHA .....	10
5.1.	Vendndodhja .....	10
5.2.	Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave .....	10
6.	RAPORTIMI.....	11
6.1.	Kërkesat e Raportimit.....	11
6.2.	Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve .....	11
7.	KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA .....	11
8.	GARANCIA .....	12
9.	PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT.....	12
10.	AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT .....	13

11.	TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT .....	13
12.	KËRKESAT FUNKSIONALE.....	13
13.1	Kërkesat teknike për sistemin software .....	13
	Funksionalitete dhe Bllokskema .....	18
14.1.1	Arkitektura dhe përgjithësime teknike .....	18
14.1.2	Moduli i Arkives Digjitale.....	19
14.1.3	Moduli i Raportimit dhe analizes se te dhenave BI.....	20
14.1.4	Moduli i kërkimit dhe filtrimit;.....	20
14.1.5	Moduli i Auditimit.....	20
14.1.6	Moduli i përdoruesve dhe te drejtave ne sistem .....	21
14.1.7	Organizimi i dokumentave.....	22
	Raportet.....	24
	METADATAT.....	25
	KLASIFIKIMI DHE KATEGORIZIMI I DOKUMENTACIONIT .....	25
	Bazë e të dhënave RDBMS.....	28
	OCR .....	30
15.	ARKITEKTURA .....	31
15.1.	Server për aplikacion .....	31
15.2	Server për databaze .....	33
15.3	SAN Switch .....	34
15.4	Storage Kryesor .....	34
15.5	Software Backup.....	35
15.6	Platforme për menaxhimin e infrastrukturës virtuale .....	36
15.7	UPS .....	37
15.8	SKANER A4.....	39
15.9	Skaner Fotografik.....	40
15.1.0	Paisje sigurie firewall.....	40

## 1. HYRJE

---

### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

## **1.2. Historiku**

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore ashtu si çdo institucion tjetër publik gjatë ushtrimit të funksioneve të saj administrative e pasqyron veprimtarinë e saj nëpërmjet dokumentacionit zyrtar. Proçesi i menaxhimit të dokumentave zyrtarë të brendshme, të dokumentave hyrëse dhe dalëse kryhet sipas procedurave standarte të veprimit të miratuara në Institucion bazuar kjo në përcaktimet ligjore për këtë qëllim. Deri në ditët e sotme ky proces është realizuar në mënyrë manuale duke krijuar kështu vështirësi në procesin e ruajtjes, administrimit, dhe menaxhimit me efikasitet maksimal të këtyre dokumentave dhe duke krijuar shpesh herë vonesa në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit që lidhet me to për qytetarët apo për vet strukturat brenda Institucionit.

## **1.3. Situata Aktuale në DPTTV**

Aktualisht në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore proçesi i ruajtjes dhe menaxhimit fundor të dokumentave realizohet nga një strukturë e posacme pranë Institucionit. Numri i madh i dokumentave të administruara nga Institucioni përgjatë viteve si dhe llojshmëria e tyre ka rezultuar në rritjen e vështirësisë së administrimit të tyre për vet strukturat menaxhuese si dhe vonesë në vënien e tyre në dispozicion për qytetarët apo edhe për vet strukturat brenda Institucionit.

Deri më sot proçesi i arkivimit të dokumentacionit kryhet vetëm fizikisht, fakt i cili sjell vështirësi në menaxhim, mbarëvajtjen dhe vënien në dispozicion të tyre kur nevojiten por dhe në aspektin e sigurisë.

Me kalimin e viteve, dokumentat zyrtarë të institucionit si shkresat hyrëse-dalëse, kontratat, urdhra, urdhëresa, dokumentat e projekteve dhe kontratave të zhvilluara etj. kanë arritur në volume të mëdha dhe kanë zenë një hapësirë të madhe fizike duke vështirësuar kështu jo vetëm proçesin e ruajtjes së tyre por edhe procesin e kërkimit nga stafi i institucionit. Kërkimi i informacioneve specifike kërkon një sasi kohe relativisht të madhe nga punonjësit. Për të evituar një proçes të tillë, si edhe për të reduktuar kostot, orët e punës dhe për të përshpejtuar proçesin e kërkimit të një dokumenti apo praktike të caktuar si dhe vënien e tij në dispozicion të qytetarit/bizneseve/punonjësve të institucionit, synohet të realizohet konvertimi i tyre në dokumente digjitale, të cilat mund të arkivohen elektronikisht, menaxhohen në mënyrë efçente, aksesohen dhe riprodhohen lehtësisht si dhe përftohet një kopje e dytë backup duke siguruar kështu dokumentacionin që administrohet në Institucion.

Për këto arsye lind nevoja e implementimit të një projekti që synon:

- Ndërtimi i një sistemi elektronik në funksion të digjitalizimit të procesit të arkivimit të dokumentave shkresor, i aftë për të menaxhuar procesin e ruajtjes (arkivimit), administrimit, kërkimit të dokumentacionit shkresor në institucion dhe riprodhimit të tij.
- Të realizojë klasifikimin e dokumentave sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga Institucioni dhe konform legjislacionit në fuqi.
- Furnizimin e hardware në funksion të projektit.
- Trajnim dhe ngritje të kapaciteteve të stafit.

- Garanci për mbarëbajtjen e sistemit për një periudhë 12 (dymbëdhjete) muaj nga data e marrjes në dorëzim të tij.

## **2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA**

---

### **2.1. Objektivi i Përgjithshëm**

Objektivi i përgjithshëm i projektit:

- Implementimi i një sistemi për digjitalizimin, përpunimin, organizimin dhe indeksimin e dokumentëve shkresorë si dhe riprodhimin e tyre duke siguruar një kopje identike, elektronike të dokumentave zyrtarë fizike (letër).
- Optimizimi dhe digjitalizimi i proceseve të punës së institucionit për strukturën përkatëse në Institucion dhe palët që ndërveprojnë në proces.

### **2.2. Qëllimi**

Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi elektronik i cili do të mundësojë:

- Sistemi që do të implementohet duhet të jetë i bazuar në standardet të përgjithshme nderkombetare për arkivim.
- Konvertimin dhe ruajtjen e dokumentave të institucionit nga formati zyrtar (letër) në format digjital.
- Menaxhim në mënyrë efikente të dokumentave. Dokumentat e digjitalizuara dhe indeksuara duhet të kalojnë në mënyrë automatike në sistem, të ruhen në hapësirën digjitale përkatëse, ku më pas përdorimi i tyre mund të gjurmohet, dokumentohet, menaxhohet dhe riprodhohet.
- Gjetje të dokumentit të duhur në formën më të shpejtë dhe më të lehtë. Dokumentat të cilat përmbajnë fjalë kyçe të përshtatshme në tekstin e tyre ose që kanë informacionin e duhur në meta-data (të dhënat përshkruese të dokumentit) mund të identifikohen dhe të gjenden lehtësisht.
- Aksesimi i dokumentave në çdo kohë nga përdoruesit me të drejtat e nevojshme. Dokumentat digjitale mund të thërriten elektronikisht nga çdo ambient ruajtjeje dhe mund të ndahen lehtësisht më pas me email apo në ndonjë formë tjetër, duke zëvendësuar kështu kopjen fizike të tyre dhe duke kursyer kohën që do të merrte procesi i kërkimit fizik dhe fotokopjimit.
- Përmirësimi i efikasitetit dhe i efektivitetit në punë të të gjithë kapitalit njerëzor dhe dhënies së shërbimit në një kohë sa më të shpejtë.
- Rritja e sigurisë së dokumentacionit nëpërmjet krijimit të një kopje identike me origjinalin (kopjen fizike).
- Hedhjen dhe ruajtjen e materialeve digjitale të formateve të ndryshme dhe mundësinë e aksesit të tyre në ndërfaqen e përdoruesit sipas të roleve dhe të drejtave të tyre.

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit

të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit

### **2.3 Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori**

Në përfundim të projektit operatori ekonomik fitues duhet të ketë permbushur detyrat e listuara në vijim:

- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të arkivimit digjital sipas specifikimeve teknike dhe funksionaliteve të kerkuara, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare dhe nderkombetare të kerkuara. Sistemi i arkivit digjital duhet të implementohet në përputhje me workflow apo rrjedhën e punës së proceseve të punës së Autoritetit Kontraktor(AK).
- Të ketë testuar dhe korrigjuar të gjitha gabimet e dala gjatë fazes së testimit.
- Të ofrohet shërbimi gjatë ditëve dhe orëve të punës së autoritetit kontraktor, pa gabime.
- Trajnimi i përdoruesve të të gjithë niveleve
- Dorëzim i dokumenteve dhe manualeve teknike dhe manualeve të përdorimit në gjuhën shqipe.
- Garanci për mbarëbajtjen e sistemit për një periudhë 12 (dymbëdhjete) muaj nga data e marrjes në dorëzim të tij.

## **3. SUPOZIMET DHE RISQET**

---

### **3.1. Supozimet e Projektit**

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore presupozon që sistemi elektronik i cili do të mundësojë forcimin e kapaciteteve menaxhuese bashkë me të gjitha të dhënat që nevojiten për funksionimin e tij do të instalohet pranë ambjenteve të Datacenter.

- Niveli i angazhimit dhe mbeshtetjes së plotë të të gjithë aktoret të përfshira në këtë projekt.
- Analiza e plotë dhe e saktë e të gjithë proceseve të punës dhe roli i çdo përdoruesi në çdo hap;
- Përcaktimi i saktë i të drejtave të përdoruesve në sistem;
- Monitorimi i vazhdueshëm i sistemit edhe pas implementimit që të ruajë performancën pas shtimit të dokumenteve të digjitalizuara dhe të dhënave në sistem;

### **3.2. Risqet**

Duke u bazuar në nevojën imediate të një sistemi, për të ruajtur menaxhuar dhe ndjekur në formë elektronike informacionin e bazuar në dokumenta zyrtarë (letër), Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore e konsideron një prej projekteve më të rëndësishme të saj.

Si çdo projekt, ekzistojnë një sërë risqesh për implementimin dhe përfundimin me sukses të këtij projekti. Disa prej tyre renditen si më poshtë:

- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në këtë proces, që mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të projektit;
- Mungesa apo mosperputhjet me ndryshimet ligjore/administrative/procedurale për të qenë konsistent me procesin e ndjekur elektronikisht;
- Paqartësia e kërkesave apo kuptimi jo i saktë dhe rrjedhimisht implementimi jo i saktë nga operatori ekonomik. Plani i punës përmban një fazë të dedikuar për qartësimin e kërkesave, në vijim të së cilës nuk do të pranohen ndryshime madhore të kërkesave.
- Eksperienca e stafëve që do të përfshihen në realizimin e projektit.
- Mungesa e përshtatshmërisë së sistemit me kërkesat dhe pritshmëritë e përdoruesve.

## 4. QËLLIMI I PUNËS

---

### 4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen nëpërmjet këtij projekti është e listuar më poshtë:

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetqeverisjen Vendore”
- Legjislati i mbi arkivat dokumentare.
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Ligji Nr. 10 273, datë 29.04.2010 "Për Dokumentin Elektronik";
- Ligji Nr. 10 325, datë 23.09.2010 "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore";
- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

#### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Detyrat kryesore që lindin nga zbatimi i këtij projekti, përfshijnë (por nuk kufizohen në):

- Analizë e detajuar e nevojave dhe kërkesave lidhur me procesin e ruajtjes, menaxhimit dhe ndjekjes në kohë të dokumentacionit zyrtar që trajtohet nga institucioni.
- Dokumentimi i kërkesave, planifikimi i projektit.
- Sigurimi/implementimi i një sistemi elektronik që përmbush kërkesat funksionale dhe teknike të paraqitura në këtë dokument.
- Testimi dhe optimizimi i sistemit elektronik.
- Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve hardware.
- Përgatitja e ambjentit për instalimin e sistemit.
- Trajnimi i stafit mbi përdorimin e sistemit si edhe përgatitja e manualeve të përdorimit.
- Garanci për mbarëbajtjen e sistemit për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e marrjes në dorëzim të tij.

#### 4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

#### 4.1.3. Grupet e synuara

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

#### 4.1.4. Siguria e sistemit

Mënyra e logimit në sistem do të jetë me emër përdoruesi dhe fjalëkalim. Asnjë përdorues nuk mund të aksesojë sistemin pa patur kombinim të saktë përdorues dhe fjalëkalim.

Sistemi të ketë të implementuar 2 hapa sigurie ( pasi të vendoset fjalëkalimi i sakte, ti nisët një kod në e-mail/tel dhe pasi të vendosi këtë kod të aksesojë sistemin).

Përdoruesit kanë të drejta të mirëpërcaktuara në sistem sipas rolit që ata kanë. Përdoruesit kanë të drejta në sistem të përcaktuara për çdo proces dhe hap në workflow ku ata kanë akses. Përdoruesit që do të kenë rolin e administratorit të sistemit do të kenë mundësi që të administrojnë rolet, përdoruesit dhe të drejtat e tyre në sistem. Ata mund të krijojnë, modifikojnë e caktivizojnë përdoruesit ekzistues. Administratorët gjithashtu mund të konfigurujnë fortësinë e fjalëkalimit sipas standardit të sigurisë që ata do të duan të vendosin në aksesimin në sistem.

Sistemi që do të ndërtohet duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, "Për miratimin e rregullores 'Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore'", në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Masa për sigurinë:

- Sistemi nuk duhet të lejojë krijimin e llogarive pa password;
- Administratorët nuk duhet të shikojnë password-et e përdoruesve, pra ato duhet të ruhen të shifruar në databazë;

Opsionet:

- Grupet e përdoruesve do të jenë:
  - o Administrator i sistemit;
  - o Përdorues të tjerë, të ndarë sipas roleve të përcaktuara nga Administratori;
- Gjurmimi i veprimeve, detektimi dhe parandalimi i nderhyrjeve, auditimi
- sistemit, duhet bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore dhe niveli i sigurisë duhet të jetë: D2I2K1-M

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	
<input type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U



<input type="checkbox"/> D2	<input type="checkbox"/> I2	X K2	<input type="checkbox"/> M
X D3	X I3		X L

- Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.
- Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.
- Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

#### 4.1.5 Detyrat specifike

##### **FAZA I: Faza Fillestre**

1. Intervistimin e të gjithë kategorive të përdoruesve që mendohet të përdorin sistemin,
2. Analizimin e bazës ligjore dhe të rregulloreve që disponon AK.
3. Analizes se standardeve ndërkombetare të arkivimit.
4. Përpilimin dhe dorëzimin e raportit të analizës së biznesit tek AK.
5. Marrja e aprovimit të raportit të Analizës së Biznesit nga AK.

##### **FAZA II: Zhvillimi i sistemit në ambientin test të OE**

- Zhvillimi/implementimi i sistemit të arkivit digjital sipas workflow-ve të bazuar në analizën e biznesit të aprovuar nga autoriteti kontraktor, dhe kërkesa teknike dhe funksionale të parashikuara në këtë dokument.
- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të arkivit digjital në ambientin test

##### **Faza III – Zhvillimi i Software për backup.**

##### **FAZA IV: Faza e testimit të sistemit software dhe sistemit të backup.**

1. Testimi i të gjithë moduleve të sistemit të arkivit digjital.
2. Testimi i të gjithë funksionaliteteve të kërkuara nga AK.
3. Testimi i sistemit të manaxhimit të backup.
4. Përpilimi dhe dorëzimi i test case me gjithë rezultatet e testimit
5. Përpilimi i raportit final të testimit.

##### **FAZA V: Trajnimi i stafit përdorues**

Trajnimi i përdoruesve

1. Trajnimi përdoruesve me të gjithë moduleve të sistemit të arkivit digjital.

2. Trajnimi përdoruesve me të gjithë funksionalitet e sistemit të arkivit digjital të kërkuara nga AK.
3. Përpilimi i raportit final të trajnimit të përdoruesve.

#### **FAZA VI: Furnizimi, instalimi, konfigurimi dhe integrimi i pajisjeve hardware**

1. Furnizimi i pajisjeve hardware.
2. Instalimi dhe konfigurimi në datacenter.
3. Integrimi me infrastrukturën përkatëse në Institucion

#### **FAZA VII: Dorezimi i kodit burim, skicave, konfigurimeve dhe manualeve te instalimit**

1. Kodi burim i sistemit, ku pronar do jete DPTTV
2. Të gjithë komponentët si dhe dokumentimi i të gjitha konfigurimeve përkatëse.
3. Manuali i instalimit te sistemit nga fillimi ( ku përfshin dhe restore te DB)
4. Plani i vazhdimësisë së biznesit

Ne përfundim të fazes VII për efekt të testimit të sistemit live, OE do të skanojë nga arkiva fizike e AK , një total prej 10,000 flete .

#### **FAZA VIII: Marrja në dorëzim**

- Dorëzimi i sistemit. Pasi të gjithë proceset dhe funksionalitetet të jenë testuar dhe provuar dhe pasi të jetë realizuar dhe trajnimi i stafit, do të bëhet dorëzimi final i sistemit. Në dorëzimin final do të përfshihen:
  - Dorëzimi i sistemit.
  - Dorëzimi i manualeve të përdoruesit.
  - Dorëzimi i dokument teknik, duke përfshirë dhe kodin burim të sistemit.

## **5. LOGJISTIKA DHE KOHA**

---

### **5.1. Vendndodhja**

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

### **5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave**

- Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës.
- Afati i implementimit të sistemit me të gjithë komponentët përbërës është 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

## 6. RAPORTIMI

---

### 6.1. Kërkesat e Raportimit

Kontraktori do të paraqesë raportet e mëposhtme në Shqip në origjinal dhe 2 kopje:

1. **Raporti Fillestar** prej maksimumi 20 faqesh duhet të prodhohet pas një Muaji nga data e nënshkrimit të kontratës. Në raport Kontraktori duhet të përshkruajë gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritur ose të hasur. Kontraktori duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgojë komente mbi raportin fillestar.
2. **Drafti i raportit përfundimtar** i faqeve maksimale 20 (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 2 Muaj para përfundimit të periudhës së implementimit të sistemit dhe komponentëve përbërës të tij.
3. **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 20 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar.

### 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës të identifikuar në kontratë.

Grupi i punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

AK duhet të realizojë aprovimin e raporteve të mesiperme apo çdo raport tjetër të ndërmjetëm që mund të kërkojë gjatë projektit brenda një afati 5 ditësh nga marrja e raportit. Nëse nuk zbatohen këto afate në kohë, atëherë raporti quhet i aprovuar automatikisht dhe vijohet me proceset e radhës.

## 7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

---

Sistemi duhet të jetë i integruar me skanerat dhe sistemet e tjera të kryerjes së digjitalizimit të arkivës fizike.

Zgjidhja e ofertuar duhet të lejojë integrim dhe komunikim me sisteme të ndryshme në të ardhmen brenda ose jashtë rrjetit informatik të AK.

Sistemi duhet të ofrojë mundësi integrimi me sisteme të tjera nëpërmjet WEB API për të mundësuar komunikimin me sisteme të tjera sipas kërkesave dhe nevojave të autoritetit në çdo kohë /edhe gjatë fazës së mirëmbajtjes.

Sistemi duhet të jetë i integruar me sistemin e taksave dhe tarifave vendore si dhe me sistemet e tjera

## 8. GARANCIA

---

Periudha e garancisë së pajisjeve hardware, sipas përcaktimeve përkatëse në këtë dokument.

Periudha e garancisë së software 1 vit.

## 9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT

---

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi\Njësi	Vlera
1	Server për aplikacion	Copë	1		
2	Server për databaze	Copë	1		
3	Paisje sigurie firewall	Copë	1		
4	SAN Switch	Copë	2		
5	Software backup	Copë	1		
6	Platforme për menaxhimin e infrastrukturës virtuale	Set	1		
7	UPS	Copë	2		
8	Storage Kryesor	Copë	1		
9	Skaner A4	Copë	2		
10	Skaner Fotografik	Copë	1		
11	Sistemi elektronik i dokumentacionit (zhvillim, testim, instalim, restore)	Sherbim	1		
12	Konfigurime te Infrastruktures	Sherbim	1		
13	Trajnim	Sherbim	1		
TOTALI PA TVSH (LEKË)					
TVSH (LEKË)					
TOTALI ME TVSH (LEKË)					

## 10.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

---

Nr	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M3-6
1	Përpilimi dhe dorëzimi i raportit të analizës së biznesit.				
2	Zhvillimi i sistemit software				
3	Zhvillim i software për backup				
4	Testimi i sistemit software dhe software për backup				
5	Trajnimi i stafit përdorues				
6	Furnizimi, instalimi, konfigurimi dhe integrimi i pajisjeve Hardware				
7	Dorëzimi i kodit burim, skicave, konfigurimeve dhe manualeve të instalimit)				
8	Marrja në dorëzim				

## 11.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT

---

- Autoriteti kontraktor do të jetë pronar i kodit burim të sistemit dhe çdo dokumentacion teknik (mënyrën e konfigurimit të sistemit elektronik, skica, etj.)

-OE do të mbajë përgjegjësi ligjore për funksionimin e kodit burim të dorëzuar

## 12.KËRKESAT FUNKSIONALE

---

### 13.1 Kërkesat teknike për sistemin software

Zgjidhja software duhet të jetë e bazuar në teknologjinë web dhe të ofrojë ndërfaqe të unifikuar të përdorimit. Zgjidhja software duhet të bazohet mbi proceset e biznesit dhe mbi platforme low-code/no-code. Më poshtë vijojnë kërkesat funksionale sipas moduleve përberëse të identifikuara për zgjidhjen e kërkuar.

Sistemi duhet të plotësojë kërkesat teknike si vijon:

Modularitet	<p>Zgjidhja duhet te jete modulare dhe te krijoje mundesine e zgjerueshmerise ne te ardhmen nese AKka deshire te shtoje module te tjera ne kete sistem nepermjet krijimit te formave dhe workflowve te rinj.</p> <p>Sistemi duhet të ketë minimalisht modulet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Moduli i arkives digjitale,</li> <li>• Moduli i përdoruesve, i të drejtave në sistem</li> <li>• Moduli i kërkimit dhe filtrimit;</li> <li>• Moduli i raportimit dhe analizes se te dhenave BI</li> <li>• Moduli i Auditimit</li> </ul>
Arkitekture e shtresezuar	Sistemi duhet te bazohet mbi nje arkitekture te shtresezuar.
Arkitekture SOA	<p>Sistemi duhet te kete arkitekture te orientuar drejt sherbimeve.</p> <p>Per realizimin e veprimeve te cilat realizohen nga GUI duhet ekspozohen web sherbime te standartit SOAP dhe REST.</p>
Gjurmimi i veprimeve te perdoruesve	<p>Sistemi duhet te gjurmojë dhe të ruajë veprimet e perdoruesve dhe te ofroje mundesi te shfaqjes dhe kerkimit te tyre ne menyre te thjeshte.</p> <p>Sistemi duhet te ruaje vlerat e ndryshuara te perdoruesve dhe te shfaqe historikun e ndryshimeve te bera ne lidhje me nje subjekt.</p>
Perdorimi i teknikave te multiprocessingdhe multithreading	Sistemi duhet te perdore teknikat multiprocessing dhe multithreading per te perdorur ne menyre optimale kapacitetet fizike te serverave.
Ruajtja e vlerave te shifruara	Sistemi duhet te kete ne nivel te komponentes se nderfaqesimit me databazen algoritme per shifrimin ete dhenave, ne menyre te tille qe fusha me informacion sensitiv te ruhen te shifruara. (te enkriptuara).
Veprimet transaksionale	Sistemi duhet te garantoje veprime transaksionale me databazen duke ruajtur integritetin relacionar te te dhenave (ruajtja e nje te dhene te behet vetem nese te gjitha proceset qe kane te bejne me te jane perfunduar me sukses).
Checksum	Të ruhet checksum i cdo dokumenti per te garantuar origjinalitetin e dokumentit te skanuar.

Teknologji WEB	Sistemi duhet te jete i bazuar ne teknologji web, dhe duhet te jete i aksesueshem nga te gjithë shfletuesit e internetit ne versionet e tyre me te fundit si psh: Google Chrome, MS Internet Explorer, Mozilla Firefox, Safari, Opera.
Nderfaqet e Sistemit	Nderfaqet e sistemit duhet te jene te thjeshta, të përshtatura me terminologjinë e duhur, dhe të jene të gjitha ne gjuhen Shqipe.
Kosto per perdorues	Sistemi nuk duhet te kete kosto shtesë të licensimit per perdorues
Kosto nga pale te treta	Sistemi duhet te ofroje mundesine e operimit pa kosto per licensa software nga pale te treta ne menyre qe neafatgjate te ulen kostot operacionale te mirembajtjes.
Vula digjitale	Sistemi duhet te ofroje shërbime të integritit me vulen digjitale ne menyre qe dokumente te caktuar te printuar nga sistemi te mbajne edhe vulen digjitale te institucionit nese kerkohet nga AK.
Hyper V Failover Cluster	Instalimi i sistemit duhet te implementohet ne Hyper V Failover Cluster ne menyre qe nese ka nje problem nje makine virtuale, atehere automatikisht funksionon makina virtuale ne nje server tjeter fizik.
Integrim me sisteme te tjera	Sistemi duhet te ofroje mundesine qe te integrohet me sisteme te tjera. Te integrohet me sistemin e taksave.
Bazuar ne standardet nderkombetare dhe legjislacionin ne fuqi	Sistemi duhet të përfshijë implementimin në përshtatje me standartet nderkombetare të përshkrimit arkivor (ISAD(G)) dhe legjislacionin në fuqi për arkivat.
Implementimi i barcode	Sistemi duhet të implementojë përdorimin e barcodeve duke bërë të mundur që dokumentat qe arkivohen ne arkivin digjital te pajisen me nje kod unik. Ky kod unik shërben edhe per kerkim te shpejt ne sistem.

Template dosjesh /dokumentesh	<p>Te jete mundesia qe te percaktohen tipe te ndryshme dosjesh dhe dokumentash te cileve i caktohen template te vecante duke i pecaktuar elementet e kokes, fundit dhe vulen digjitale dhe metadata.</p> <p>Te kete dhe elemente dinamik si psh data dhe ora e printimit te dokumentit, emri i perdoruesi qe e printoi dokumentin.</p>
Formati i ruajtjes se te dhenave	Sistemi të ruajë më shumë se një format të dokumenteve të digjitalizuar të cilët ofrojnë faktorë qëndrueshmërie dhe cilësie të lartë për sa iu takon ruajtjes digjitale afatgjatë.
Kerkim i avancuar	<p>Motori i kërkimit të mundësojë kërkimin “full text search” dhe “linguistic search në përmbajtjen e dokumenteve (te skanuara me OCR) ose sipas fushave të kerkimit psh: në titull dokumenti, numër, datë, emer, mbiemer, emertimi etj.</p> <p>Motori i kerkimit duhet te jete njekohesisht nje motor “analytics” me RESTful API.</p>
Rezultati i kerkimit	Rezultatet e kërkimit duhet të shfaqen në formë të kuptueshme dhe të thjeshtë për përdoruesin dhe të jenë të printueshme.
Gjurmimi i veprimeve	Sistemi duhet te siguroje gjurmimin e veprimeve të kryera nga përdoruesit e sistemit, gjenerimin e raporteve të ndryshme për qëllime statistikore, përmirësimi procesesh, sigurie dhe mirëmbajtje, si dhe opsione për auditimin e sistemit duke siguruar njëstresë Konformiteti (Compliance) të proceseve dhe dokumentacionit.
Ruajtje e tentativave per akses te paautorizuar	Akresi duhet tu lejohet vetëm personave të autorizuar, dhe cdo përpjekje për akses të paautorizuar duhet të raportohet ne mënyre automatike nga sistemidhe te ruhet per te qene mundesia qe te shfaeqt neperraporte dhe per qellime auditi ne te ardhmen.
Ruajtja e Statuseve te proceseve	Cdo procesi duhet te jete mundesia ti konfigurohen statuset e mundshme.




Vendosja e Njoftimeve ne Tranzicion Statusi	Sistemi duhet te ofroje mundesine per njoftimin e perdoruesve ne rast se nje kerkese e re vjen apo nje formular ndryshon status. Njoftimi duhet te realizohet te pakten me ane te email.
Njoftime per ceshtje pezull dhe ato jashte afateve	Ne varesi te konfigurimit te procesit, moduli duhet te njoftoje ne nderfaqen kryesore perdoruesin per ceshtjet pezull (ceshtje te cilat nuk jane perditesuar per nje afat kohor te konfigurueshem), ceshtjet e vonuara (nese te pakten nje prej fushave te nje prej formulareve ka kaluar afatin per plotesim). Keto njoftime te behen dhe me email.
Komente dhe Skedare shtese	Moduli duhet te ofroje mundesine e shtimit te komenteve ne nje ceshtje. Perdoruesit duhet te mund te permendin perdorues te tjere. Perdoruesve te permendur duhet tu dergohet email me link e ceshtjes.
Konfigurimi i Ceshtjeve	Ne varesi te dokumentave qe qarkullojne, sistemi duhet te mundesoje konfigurimin e proceseve te cilet perfshijne formulare te ndryshem, rregulla per qarkullimin e ketyre formulareve ne forme elektronike ne perdorues te ndryshem dhe afate per plotesimin e tyre apo fushave specifike te tyre.
Krijimi automatik i ceshtjeve	Ceshtjet duhet te mund te krijohen ne menyre manuale nga perdoruesit por gjithashtu edhe ne menyre automatike si psh: Kur ngarkohet ne sistem nje dokument i skanuar te nje tipi te caktuar.

Sistemi elektronik që do të ndërtohet, duhet të sigurojë që:

- a) dokumenti elektronik të ruhet në formën që është krijuar dhe ruajtur, duke mos ndryshuar asnjë element të tij;
- b) dokumenti elektronik të ruhet nëpërmjet procedurave dhe teknologjive, që sigurojnë garanci për pacënueshmërinë dhe tërësinë e tij përgjatë gjithë kohës së ruajtjes, si dhe mosfshirjen pa autorizimin përkatës;
- c) dokumenti elektronik, gjatë kohës së përcaktuar të ruajtjes, të jetë në formë të lexueshme, në dispozicion të personave që kanë të drejtën e aksesit në të;
- d) të mundësojë përcaktimin në mënyrë të besueshme të çdo dokumenti elektronik, të origjinës së tij, krijuesit, kohës, mënyrës dhe formën e marrjes në sistemin e ruajtjes;
- e) procedura e mirëmbajtjes së sistemit të ruajtjes së dokumentit elektronik të mos çënojë paprekshmërinë e dokumentit elektronik.

Afatet kohore të ruajtjes së dokumentit përcaktohen sipas natyrës dhe rëndësisë që ai paraqet konform listës tip të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Drejtorisë së Arkivave që quhet “Lista tip me afatet e ruajtjes së dokumentave me rëndësi historike kombëtare”, në të cilin janë të përcaktuara shumica e tipave të dokumenteve dhe afatet korresponduese të ruajtjes së tyre si dhe dokumentet të cilat nuk klasifikohen me vlerë. Dokumentet me Rëndësi Historike Kombëtare (RHK), ruhen përkohësisht në institucion sipas përcaktimeve përcaktëse ligjore. Në përfundim të afatit të ruajtjes së tyre, ato asgjësohen sipas procedurave të mirëpërcaktuara. Pjesa tjetër e dokumenteve të klasifikuara si dokumenta me vlerë RHK, dërgohet për ruajtje **përgjithmonë** në institucionet arkivore korresponduese.

Figura e mëposhtme paraqet skematikisht hapat e rrugëtimit të dokumentave gjatë ciklit të jetës së tyre:



Figurë 1: Paraqitja e ciklit të jetës së një dokumenti, nga krijimi deri në arkivim

## Funksionalitete dhe Blokskema

### 14.1.1 Arkitektura dhe përgjithësime teknike

Modulet e sistemit software duhet të jene konceptualisht të ndërtuar në përputhje me nevojat e AK dhe duhet të plotesoje të gjithë kerkesat në menyrë gjithëpërfshirëse, të dhenat të jene të nderthurura mes tyre për të dhënë informacion të vlefshëm sipas kerkesave të përdoruesve, të sherbeje në veçanti për çdo përdorues dhe pozicion pune sipas rolit dhe të drejtave që ky i fundit duhet të ketë në sistem.

Nderfaqet dhe proceset e punës duhet të jene të modifikueshme në menyrë të thjeshtë e të shpejtë, nëpërmjet ndërfaqeve perkatëse grafike, në menyrë që sistemi të jete dinamik dhe fleksibel duke dhënë mundësi të pershtatjes me situata dhe procedura të reja që mund të shfaqen në të ardhmen.

## 14.1.2 Moduli i Arkives Digjitale

Sistemi duhet te ofroje nje modul per arkivimin digjital te dokumenteve. Ky modul duhet te mundësojë regjistrimin e dokumentare arkivore e cila ruhet në arkivin e AK, administrimin, ruajtjen dhe kërkimin për të dhëna. Regjistrimi i të dhënave arkivore duhet të mundësohet duke u bazuar në standartin nderkombetar te pershkrimit arkivor dhe normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Për çdo nivel klasifikim sistemi duhet te ofroje nje template, i cili te kete te percaktuar fushat perkatese.

Pervec regjistrimit te te dhenave pershkruese arkivore, sistemi duhet te mundesoje edhe regjistrimin e te dhenave te vendruajtjeve (sallat ku vendosen dokumentet arkivore). Këto te dhena duhet te japin informacion te sakte ne lidhje me vendodhjen fizike te dosjeve. Psh nr. Salles, nr. raftit, nr i rreshtit, nr i arkes, numri i kutise, nr. i dosjes.

Disa kerkesa te tjera funksionale te pergjithshme per arkiven digjitale jane:

- Sistemi i arkivit digjital duhet të afrojë mundësinë e ruajtjes së dokumentave te tipeve te ndryshme duke përfshirë dokumente shkresore, fotografi, mikrofilm, rregjistra, kartela, dokumente audio, dokumente video etj.
- Sistemi duhet të mundësojë paraqitjen e nivele të pershkrimit arkivor : fond/viti/dosje dokument në formë peme (hierarkie) dhe në formë të detajuar.
- Për secilën kategori dokumentesh, sistemi duhet të ofrojë mundësinë e regjistrimit të metadatave pershkruese, teknike, dhe metadatat e administrimit. Metadat teknike dhe metadatat e administrimit duhet të jenë të gjenerueshem në mënyrë automatike nga sistemi.
- Sistemi duhet të ofrojë ruajtjen nje numri te madh dokumentesh, mbi 30,000,000 faqe te madhesive te ndryshme, te grupuar sipas skemes dhe logjikes se AK. Ky numer nuk duhet te ndikojte ne funksionimin dhe performancen e sistemit.
- Sistemi software duhet të jetë i pajisur me motor kërkimi dhe të mundësojë kërkimin për të dhëna dhe dokumente në disa forma:
  - Motori i kërkimit të mundësojë kërkimin “full text search” dhe “linguistic search në përmbajtjen e dokumenteve (te skanuara me OCR)
  - Motori i kërkimit të mundësojë kërkimin sipas fushave të kerkimit psh: në titull dosje, numër, datë, emer, mbiemer, emertimi fondi etj.
  - Motori i kerkimit duhet te jete njekoheisht nje motor “analytics” me RESTful API.
- Duhet të ofrojë mundësinë e shifrimit të skedarëve në server ose ne shfletues.
- Duhet te ofroje mundesine e ruajtjes se nje kopje te skanuar origjinale dhe kopjeve te tjera mbi te cilat mund te punohet.
- Duhet të mundësojë versionimin e dokumentave. (track changes)
- Duhet të mundësojë krijimin e dosjeve të ndara me përdorues të tjerë.
- Duhet të bëjë indeksimin në nivel dokumenti,kodi vendor në varësi të fushave pershkruese të cilat plotësohen nga përdoruesit dhe mundësojë kërkim më të shpejtë të sipas këtyre fushave.
- Duhet të bëjë indeksim të dokumenteve për aq sa eshte e mundur nga te dhenat e ORC te marra nga skanimi/digjitalizimi i dokumenteve arkivore.
- Sistemi duhet të jetë i integruar me pajisjet skanimi që disponon AK, si dhe të jetë lehtësisht i konfigurueshëm me pajisjet skanimi që mund të përdorë në të ardhmen institucioni.

- Sistemi duhet të ofrojë ndërfaqe komunikuese për pajisjet e skanimit dhe ngarkimin e skedareve të skanuar/digjitalizuar në sistem.
- Sistemi duhet të mundësojë printimin e rezultateve të kërkimit në të gjitha format e shfaqjes së rezulttatit të kërkimit, duke i mundësuar përdoruesit printimin e të gjithë rezulttatit apo printim të pjesshëm në varësi të fushave të selektuara.

Me ane te kesaj procedure operatori ekonomik duhet te ndertoje nje sistem qe do te permbushe te gjitha nevojat e AK per lehtesimin e tij te punes duke bere te mundur arkivimin digjital te te gjithë dokumentave, organizimin e tyre sipas standardit, kalimin e procedurave ne menyre elektronike. Kjo arkive do te beje ruajtjen me te sigurte te dokumentave, aksesim me te shpejte, kerkimme i shpejte dhe i sakte.

### **14.1.3 Moduli i Raportimit dhe analizes se te dhenave BI**

Te dhenat e aktivitetit per nje entitet jane shume te vlefshme. Analiza i tyre sjell konkluzione te cilat pasqyrojne lidhje midis faktoreve te ndryshme. Perverc reporteve standarte te cilat do paraqiten me poshte, kerkohet te ofrohet nje modul per arkivimin e te dhenave ne trajte te pershtatshme per tu analizuar ne menyre te shpejte dhe te sakte.

Perdoruesit e sistemit duhet te kene mundesi te ndertojne vet raporte sipas kerkesave te tyre per informacion. Kerkohet te mundesohet ndertimi i raporteve PIVOT ne menyre te ngjashme me programin aplikativ Microsoft Excel. Pas ndertimit te raporteve te ndryshme perdoruesit duhet te kene mundesi te krijojne grafike te ndryshem nisur nga te dhenat sintetike. Grafiket duhet te ofrojne mundesi per “drill-down” dhe “drill-through” ne te dhena. Paraqitja e informacionit ne trajten e duhur vizuale eshte shume e rendesishme per interpretimin e thjeshte te informacionit. Analiza e te dhenave duhet te jete i thjeshte ne menyre te tille qe perdoruesit te ndryshojne kriteret e analizes apo formen e shfaqjes se informacionit sipas kerkeses se momentit. Informacioni duhet te jete i aksesueshem nga pajisjet mobile per te qene sa me te perditesuar ne cdo cast. Moduli i raportimit duhet te mundesoje caktimin e privilegjeve per aksesimin e informacionit vetem nga personat e autorizuar.

Moduli i raportimit duhet te indeksoje informacionin ne menyre “inteligjente” ne varesi te perdorimit te tij me te shpeshte. Ne kete menyre raportet do te gjenerohen shpejt.

Perdoruesit duhet te kene mundesi te grupojne raportet grafike apo treguesit e performances me informacion te natyres se njejte ne panele informative sipas kerkeses. Per cdo panel informativ duhet te mund te konfigurohet frekuenca e perditesimit te informacionit qe paneli permban.

### **14.1.4 Moduli i kërkimit dhe filtrimit;**

Ky modul do te sherbej per kerkim dhe filtrim te informacionit ne Arkive

### **14.1.5 Moduli i Auditimit**

Sistemi duhet të gjurmojë aktivitetet lidhur me dokumentat e arkivuar si më poshtë:

- log in/log out;
- regjistrim

- konsultim
- editim
- fshirje
- etj

Për këto ngjarje, sistemi duhet të ofrojë llojin e aktivitetit, kohën, përdoruesin, dokumentin etj.

Sistemi duhet të gjurmojë aktivitet lidhur me përdoruesit:

- krijimi i një përdoruesi të ri
- fshirja
- modifikimi
- ndryshimi i fjalëkalimit
- të drejtat
- etj

#### **14.1.6 Moduli i përdoruesve dhe te drejtave ne sistem**

Duke qene se ky eshte nje sistem gjithepershires ku punojne perdorues me role te ndryshme, eshte e rendesishme qe cdo perdorues te kete te drejta vetem per funksionalitetet qe ky perdorues duhet te perdore. Te gjithë perdoruesit do ta aksesojne sistemin vetem nepermjet rrjetit informatik te AK. Permes ketij moduli administratori do te menaxhoje sistemin dhe perdoruesit. Moduli duhet te mos kete kufizime ne numrin e perdoruesve dhe te roleve.

*Perdoruesit e sistemit do te jene:*

*Punonjesit e institucionit.* Perdorues qe do te aksesojne sistemin me ane te emrit te përdoruesit dhe fjalëkalimit. Keta përdorues perbehen nga punonjësit e DPTTV-se te cilet e perdorin programin bazuar ne rregulloren ne fuqi.

#### **Administratori - Regjistrimi i institucionit**

- Emri i institucionit
- Adresa
- NIPT
- Tel/email/Website

#### **Administratori - Regjistrimi i departamenteve/drejtoreve**

- Emri i departamentit/Drejtoreve
- Drejtuesi
- Prindi (Për të krijuar strukturën hierarkike të departamenteve)

### **Administratori - Regjistrimi i punonjësve**

- Emri
- Departamenti/drejtoria
- Pozicioni i punës
- Të dhëna personale
- Të dhëna kontakti

### **Administratori - Menaxhimi i përdoruesve**

#### **Shtimi i përdoruesve**

- Emri i përdoruesit (Username)
- Të dhëna kontakti
- Tipi i përdoruesit
- Lidhja me punonjësin

#### **Menaxhimi i fjalëkalimeve**

- Krijimi i fjalëkalimit fillestar për përdoruesin
- Përcaktimi i mundësisë së ndryshimit të fjalëkalimit
- Njoftimi i përdoruesit
- Ndryshimi i fjalëkalimit(Reset) në rast se përdoruesi ka harruar fjalëkalimin

#### **Çaktivizimi i përdoruesve**

